



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrašnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs

Akademia e Kosovës për Siguri Publike/Kosovska Akademija za Javnu
Bezbednost Kosovo Academy for Public Safety

Bazuar në Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, **Akademia e Kosovës për Siguri Publike (AKSP), ri-shpallë shpall këtë:**

KONKURS

Titulli i vendit të punës: **Menaxher i Divizionit të Financave/ZKF**

Kategoria dhe grada e vendit të punës: **Nivel drejtues, koeficienti 9**

Nr. i ref: **AKSP 7/1-2012**

Raporton të: **Drejtori i Departamentit të Administratës së Përgjithshme**

Detyrat dhe përgjegjësit kryesore,

1. Benë planifikimin buxhetor - harmonizimin e kërkesave buxhetore nga të gjitha njësitë e AKSP-së.
2. Përpunon të gjitha të dhënat buxhetore dhe te njëjtat i fut në sistemin qeveritar BDMS (Sistemi i Zhvillimit dhe Menaxhimit të Buxhetit), po ashtu përpunon të dhënat e projekteve kapitale dhe te njëjtat i fut në sistemin PIP (Projektet për Investime Publike),
3. Planifikon rrjedhën e parasë së gatshme (Cash Flow) si dhe mbikëqyr alokimin e mjeteve në bazë të Cash Flow-ut,
4. Menaxhon dhe planifikon planin e zotimeve në bazë të planit të rrjedhës së parasë së gatshme, si dhe mbikëqyr shpenzimet e alokimeve,
5. Përpunon kërkesat për rialokime dhe ridestinime të mjeteve eventuale, për te gjitha projektet,
6. Përgatit raporte detale për të gjitha ecuritë buxhetore, nivelit të lartë,
7. Përpunon dhe përgatit pasqyrat vjetore financiare,

8. Kryen edhe detyra tjera në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm e që kërkohen kohë pas kohe nga Drejtori i Departamentit të Administratës së Përgjithshme.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim

Në shërbimin civil kanë te drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave që kërkohet për pozitën përkatëse.

Procedura e konkurimit

Për pozitën e Menaxherit të Divizionit të Financave/ZKF, procedura e konkurrimit është e hapur (për gjithë të interesuarit).

Shkollimi i kërkuar

- Përgatitje Universitare – Ekonomist i diplomuar (e obligueshme).

Aftësia, përvoja dhe atributet tjera që kërkohen

Njohuri të mira të punës me kompjuter, me aplikim të programeve (Microsoft Word, Excel, Power Point), fleksibilitet dhe aftësi për të punuar nën presion dhe brenda afateve të kufizuara kohore, aftësi për të punuar me njerëz të kulturave dhe religjioneve të ndryshme, gjinisë dhe pikëpamjeve të ndryshme politike duke ruajtur paanshmërinë dhe objektivitetin, vet-iniciativë dhe përkushtim i vëmendjes ndaj detaleve dhe aftësi për të punuar në një ambient ekipor e nevojshme. Së paku katër (4) vite përvojë pune, duke përfshi dy (2) vit përvojë pune në fushën përkatëse (e obligueshme). Njohja e njërës nga gjuhët zyrtare (e obligueshme).

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin

Përzgjedhja e Menaxherit të Divizionit të Financave/ZKF, bëhet në pajtim me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, si dhe Rregulloren Nr.07/2010 për Emërimin e Nëpunësve Civil.

Kohëzgjatja e emërimit

Për pozitën e Menaxherit të Divizionit të Financave/ZKF, emërimi është me kohë të pacaktuar (karrierës).

Data e mbylljes së konkursit

Konkursi është i hapur 7 ditë kalendarike nga data e publikimit, duke filluar nga data 08.08.2012 deri me datën 14.08.2012.

Paraqitja e kërkesave

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (AKSP), Zyra e Personelit, dhoma nr.1. kati I, ndërtesa e re administrative, Vushtrri, ose nëpërmjet adresës elektronike: habbije.cakiqi@rks-gov.net. Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohet për vendin e punës për të cilin konkurren.

“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë”.

“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen

Për informata me te hollësishme mund të kontaktoni Zyrën e Personelit nr. tel: 028 570 008 Ext 114 ose 233, prej orës 08:00 – 16:00.